



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT - OPŠTINA OBILIC
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE

Dafës-Izlasne

Nr. 11-839

Data 17.08.2021

Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova



Komuna e Obiliqit - Opština Obilic - Municipality Obiliq

Datë/Data/Date	17/08/2021
Nga/Od/From:	z. Xhafer Gashi, Kryetari i Komunës së Obiliqit
Për/Za/To:	z. Burim Gërguri, Kryesuesin e Kuvendit Komunal - Obiliq
Tema/Subjekat/Subjekt:	Raporti i Punës së Kryetarit - Janar-Qershor 2021



I nderuar,

Duke u bazuar në ligjet në fuqi, Statusin dhe rregulloret e punës në komunën e Obiliqit që parashohin edhe raportimin në kuvend të punëve të përfunduara dhe atyre që janë filluar apo janë në proces të përfundimi. Ju lutem Pranoni Raportin e Punës së Kryetarit të Komunës dhe Ekzekutivit për periudhen Janar-Qershor 2021 .

Me respekt,



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova



Komuna e Obiliqit - Opština Obilić - Municipality Obiliq

Në mbështetje të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen lokale (Gazeta Zyrtare nr. 28 te dt. 04.06.2008), nenit 73 të Statutit të Komunës, neni 72 pika 1.7 e statutit të Komunës së Obiliqit Nr. I-34 të datës 25.04.2016 Kryetari i komunës raporton për punët e përfunduara gjatë për vitin 2020.

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT TË KOMUNËS - JANAR – QERSHOR 2021

Obiliq, 2021

PËRMBAJTJA

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT TË KOMUNËS	3
1.Drejtoria e Administratës së Përgjithshme	5
2.Drejtoria e Arsmi:.....	8
3.Drejtoria e Infrastrukturës	13
4.Drejtoria e Shëndetësis dhe Mirëqenies Sociale.....	15
5.Drejtoria për Mbrojtjen e Mjedisë:.....	32
6.Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjeca.....	35
7.Drejtoria e Inspektionit.....	39
8.Drejtoria e Urbanizmit:.....	40
9. Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural.....	42
10. Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit:.....	44
11. Zyra Ligjore: Raporti i Punës.....	47
12. Zyra e Personelit:.....	48
13. Zyra për të drejta të njeriut dhe komunitete.....	50
14. Drejtoria për Ekonomi dhe Financa.....	52
15. Zyra e Prokurimit:.....	58

1. RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT TË KOMUNËS

• Raporti gjashtëmujor i punës për vitin 2021

FJALA E KRYETARIT

I nderuar Kryesues i Kuvendit, të nderuar asambleistë të Kuvendit Komunal, drejtorë, përfaqësues së institucioneve të Komunës, shoqërisë civile dhe mediave.

Kam kënaqësinë të paraqes para jush raportin gjashtëmujorë në të cilën prezantohet puna e secilës drejtori, zyre dhe njësisive organizative të komunës së Obiliqit. Ky gjashtëmujorë, është përcjellur me punë, angazhim dhe të arritura të reja në përmbushjen e synimeve dhe objektivave tona të përbashkëta në shërbim të qytetarëve të Obiliqit.

Komuna e Obiliqit, është e angazhuar fuqishëm në rritjen e transparencës komunale dhe ofrimin e shërbimeve sa më të shpejta dhe efikase për qytetarët e Obiliqit, ku edhe nga ana e Ministrisë së Administrimit dhe Pushtetit Lokal jemi renditur si komuna e tretë (3) për performancë të mirë komunale dhe llogaridhënie. Ne, si institucion i vënë në shërbimin e qytetarëve kemi krijuar një standard të ri sa përket zhvillimit të projekteve, me fillim viti, me drejtorët e drejtorive komunale, jemi fokusuar në përcaktimin e prioriteteve për realizimin e projekteve dhe investimeve kapitale për vitin 2021, duke marrë parasysh kërkesat dhe nevojat e qytetarëve të Obiliqit nga takimet e rregullta që kam zhvilluar me ta.

Gjatë këtij gjashtëmujori, kam realizuar takime të rëndësishme më përfaqësues nga institucionet e nivelit qendror duke paraqitur kërkesat, sfidat me të cilat përballet komuna e Obiliqit dhe nevojën e domosdoshme që të kemi një koordinim sa më të mirëfilltë ndër-institucional si formë e vetme për të krijuar një standard të qëndrueshëm ekonomik e social, kam zhvilluar takime të rregullta pune, me KFOR-in, OJQ-të, drejtorët e institucioneve arsimore dhe Qendrën Rinore.

Viti që lamë pas por edhe në këtë vit, po vazhdon përballja me pandeminë globale Covid-19, andaj mekanizmat antiCovid-19 brenda Shtabit Emergjent Lokal, kanë vazhduar përkushtimin e bashkëpunimin për një situatë të menaxhueshme dhe nën kontroll, rrjedhimisht, Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare, përpos shërbimeve të rregullta të saj ka vazhduar ofrimin e shërbimeve në ambulancën antiCovid-19 në trajtimin e pacientëve me këtë virus. Në luftimin dhe parandalimin e këtij virusi, duke uruar dhe shpresuar në përfundimin e kësaj betejë, ka filluar vaksinimi masiv i qytetarëve të Obiliqit në Shtëpinë e Kulturës “Xhavit Haziri”, ekipet shëndetësore të QKMF-së janë shembull për administrimin e kësaj situatë, vlerësim ky i dhënë edhe nga institucionet e nivelit qendror. Edhe në këtë vit fiskal e deri në përmbylljen e kësaj pandemie, po vijon subvencionimi i qytetarëve të prekur me Covid-19, njëkohësisht me aprovim nga Kuvendi Komunal kemi bërë lirimin e 422 bizneseve që operojnë në Obiliq nga taksa komunale.

Në këtë gjashtëmujorë të punës, kemi filluar realizimin e projekte të rëndësishme, kemi vazhduar punimet në projektet të cilat janë në proces, si dhe kemi nënshkruar marrëveshje të shumta bashkëpunimi:

Në sektorin e shëndetësisë, përpos përkushtimit të plotë në menaxhimin e situatës me Covid-19, kam nënshkruar memorandum bashkëpunimi me organizatën ISLAMIC RELIEF KOSOVA, në realizimin e projektit “Kujdesi shtëpiak për lehonat, personat e moshës së tretë dhe personat me aftësi të kufizuar”, përmes të cilit kemi angazhuar 11 profesionistë shëndetësorë për ofrimin e

shërbimeve mobile për këto kategori të shoqërisë. Në kuadër të subvencioneve të DSHMS-së, po vazhdon subvencionimi i lehonave të komunës së Obiliqit në shumë prej 150.00€.

Në sektorin e arsimit, si rrjedhojë e situatës me pandeminë Covid-19, procesi mësimor është zhvilluar nën masat antiCovid-19 dhe ka vijuar procesi i dezinfektimit të shkollave duke mbrojtur shëndetin e nxënësëve dhe mësimeve të tyre. Në kuadër të investimeve kapitale, ka filluar ndërtimi i institucionit parashkollor në fshatin Mazgit, si një kërkesë e domosdoshme e qytetarëve të atyre zonave në ofrimin e kapaciteteve të reja shkollore.

Në ambient, është punuar dhe po punohet në rritjen e hapësirave të gjelbërta, parqe të reja, sheshe e objekte të kulturës, andaj kujdesi ndaj tyre është i domosdoshëm, kështu kemi punuar në kompletimin e procedurave dhe kemi krijuar Ndërmarrjen Publike Lokale “Kastrioti SH.A” e cila do të bëjë mirëmbajtjen e rregulltë të të gjitha zonave gjelbëruese në territorin e komunës së Obiliqit. Po punohet me dinamikë të shtuar në ndërtimin e sheshit “Adem Preniqi”, një projekt ky i cili do ofrojë një pamje të re dhe modern për qytetin e Obiliqit.

Sektori i bujqësisë, si sektor primar dhe i rëndësishëm për fuqizimin e ekonomisë, jemi fokusuar në përkrahjen e kultivuesve të fushave bujqësore si dhe kam nënshkruar memorandum bashkëpunimi me organizatën ISLAMIC RELIEF KOSOVA në realizimin e projektit “Mbështetja e qëndrueshme e jetësës për familjet përmes fermave të vogla bujqësore dhe me bagëti”. Në këtë periudhë, jemi përballur me vërshimet dhe dëmtimin e kulturave të shumta bujqësore në disa zona të Obiliqit, për të cilat si institucion komunal kemi ofruar gatishmëri të plotë duke bërë krijimin e komisioneve për vlerësimin e dëmeve dhe kompenzimin e tyre për bujqit dhe fermerët e dëmtuar. Dëme si rezultat i këtyre vërshimeve ka patur edhe në ekonominë familjar, nëninfrastrukture rrugore, ku si rezultat i kësaj është dëmtuar ura këmbësorike në fshatin Graboc dhe ura e kalueshme për vetura, në të cilat janë duke vijuar punimet në ndërtimin e tyre, që të jenë të kalueshme dhe të shfrytëzueshme për banoret e asaj zone.

Në kuadër të projekteve kapitale, kemi vijuar me kompletimin e infrastrukturës rrugore dhe asaj nëntokësore, projekte këto të përcaktuara me prioritet nga qytetarët e Obiliqit. Po ashtu, në bashkëfinancim me MAPL-në, kemi filluar realizimin e projektit “Ndërtimi i trotuarit dhe ndriçimit publik në rrugën Plemetin-Obiliq”, përmes memorandumit të nënshkruar nga mjetet financiare të Grantit të Përformancës Komunale. Kemi nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me u.d kryeshefin ekzekutiv të KRU Prishtina, z. Sokol Xhafa, për projektin “Ndërtimi i gypit të ujit me material çelik me diameter DN 500mm, në gyp HDPE me diameter 560 mm”, ky memorandum përfshin ndërrimin e gypit kryesor i cili ka filluar të dëmtohet dhe si rezultat i kësaj do të ofrohen shërbime më të mira dhe furnizim i rregulltë me ujë të pijes.

Obiliqi, po ndryshon bashkë me vullnetin tonë të përbashkët për të realizuar atë që është në të mirën e qytetarëve e veçmas për ata që do të trashëgojnë të ardhmën, fëmijet tanë. Duke ju falënderuar secilin prej jush për kontributin e vazhdueshëm, ju ftojë që të jemi unik në shërbim të komunitetit dhe qytetarëve të komunës sonë!

Drejtoria e Administratës së Përgjithshme Raporti i Punës 01.01.2021 – 30.06.2021

Drejtoria e administratës në kuadër të kompetencave të saj, ka kryer punët administrative jo vetëm në shërbim të organeve të tjera të administratës, por edhe ofrimin e shërbimeve administrative për qytetarët e komunës së Obiliqit.

-Sektori i Administratës së Përgjithshme

Sektori kryen të gjitha punët profesionale, juridike të Kuvendit dhe Komiteteve obligative dhe mbikëqyrë punët në QSHQ (Zyra Pritëse).

- Ky sektor përgatit të gjitha vendimet sipas kërkesës së Kryetarit të Komunës, prokurimit dhe njësisë kërkuese.
- Përgjigjja në të gjitha kërkesat e qytetarëve drejtuar kryetarit, bordit të drejtorëve, po ashtu kemi bërë lëshimin e vërtetimeve për qëndrim në Kosovë për qytetarët e diasporës, gjithsejtë janë lëshuar 45 vërtetime.
 - I. Kuvendi Komunal ka mbajtur - 6 seanca të rregullta, 45- vendime dhe 2- rregullore
 - II. Komitetit për Politik dhe Financa- 6 seanca,
 - III. Komitetit për Komunitete- 6 seanca
 - IV. Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) ka mbajtur - 3 mbledhje.
- Gjatë periudhës raportuese kemi pasur 6 kërkesa për qasje në dokumentet publike – zyrtare të aprovuara.
- Në këtë sektor behet: përkthimi shqip-serbisht dhe anasjelltas i të gjitha materialeve për KK-se dhe komiteteve obligative , rregulloreve, vendimeve dhe materialeve tjera sipas kërkesës së drejtorive.
- behet Pranimi dhe evidenca e saktë për mallin e pranuar dhe për mallin e shpërndan si dhe futjen e të dhënave në friballanc.

Arkivi

- Zyra e arkivës (shkrimorja) e komunës mbahet në mënyrë elektronike-manuale, në këtë periudhë ka proceduar **4.319 lëndë**.
- Zyrtari për saktësime i ka proceduar – **46** saktësime dhe nga posta janë pranuar **-269** lende.

Zyra e Shërbimeve për qytetarët

- Punët e përditshme në pranim-dorëzimin e kërkesave të qytetarëve dhënia e informacioneve qytetarëve, ndihma dhe këshillat e nevojshme për realizimin e kërkesave dhe ankesave të tyre,
- Këto punë (lëndë) kryhen përmes intranetit dhe librave përkatëse, për periudhën raportuese, janë:
 - pranuar-**13,829** lëndë,
 - të miratuara **5.719** lëndë,
 - të refuzuara- **305** lëndë,

- në proces-1.494 lëndë,
- te anuluar-200 lëndë.
- te përfunduara-6.103 lëndë

Zyra e ofiqarisë

Në këtë zyre gjatë periudhës janar-qershor/2021, janë dorëzuar:

Ekstrakt lindjes	4.838
Certifikata të lindjes	1.279
Certifikata te martesës	1.172
Certifikata te vdekjes	286
Certifikata te vendbanimit	326
Certifikata e bashkësisë familjare	554
Certifikata e gjendjes martesore	187
Certifikata e shtetësisë	42
Vërtetim nga arkiva	95
Gjithsejtë	8.779
Numri i qytetareve qe kane kaluar ne regjistrin qendror	192

Zyrtarja e logjistikes

Janë Realizu Hyrje-Dalje nga Depoja, po ashtu janë realizuar kërkesat për material administrativ hyrje -dalje ne sistemin E-pasurisë po edhe hyrjet në thesar. Për momentin nuk mundemi me nxjerr raportin e-E-pasurisë sepse programi është duke u punuar nga autoriteti qendror. Gjate kësaj periudhe kam ndjek edhe trajnimet për programin e E-pasurisë pasi qe programi ka pësuar ndryshim dhe per kete arsye programi nuk është i gatshëm të nxirren te gjitha raportet.

Zyrtari i IT

Gjate kësaj periudhe nga zyrtari i IT-se janë bërë 60 formatizime dhe intervenime tek institucionet komunale si ne shëndetësi, arsim dhe shkollat e komunës si dhe janë ber shumë punë tjera duke përfshirë krijimin në SIMBNJ, 20 kyçe ne sistem dhe 92 qasje në HRM SYSTEM .

Nga lëmi e servisimit të pajisjeve të IT janë servisuar shumë pajisje duke pasur problem me rrym dhe kanë shkaktuar dëme në pajisje të IT-së janë djegur 10 Poëer suplai (pajisje të furnizimit me rrym) dhe janë përforcuar 10 pc me ram memorie pasi që na është dashur të kalojmë nga sistemet e vjetruara .

Janë ber incizimet e mbledhjeve të kuvendit si dhe transmetimi drejt përderej me teleprezenc në MAPL dhe është bere kyçja CMS ,

Vlen të ceket se kemi furnizim me – Pc IT - Kompjuter – Llap top pasi qe kanë qen te vjetruar dhe tani presim për kalimin nga Ëindoës 10 në Ëindoës 11 do Gjate kësaj periudhe

Në përdhën në fjalë kemi ber menaxhimin e kontratave digjitalizim i sallës se kuvendit , digjitalizim te rrugëve , rregullimi i kabllove ne Shtëpinë e Kulturës si pasoj e organizimit te qendrës se vaksinimit dhe konfigurimin e zebra printerit .

Aplikacionet komunale në të cilën bëj Administrimin e tyre .

1.Intranet, E-arkiva, E-pasuria, SIMBNJ, SMVP, Domenin Mun.Gov.irk.rks, CMS, Free Balancë Ëeb Aplikacion, Sistemin e MPB për riadhesim, Sistemi i votimit elektronik , Sistemi i menaxhimit te radhës,

Menaxhimin e të dhënave personale i caktuar nga ASHMDHP (MPB) gjithsej 3 raste, Menaxhimin e softuerit për Hapjen dhe caktimin e orarit të dyerve për hyrje dhe dalje, Ndërsa në QKMF menaxhimin e SISH Aplikacionit, Në Arsim kemi E-Shkollën e cili është duke u bërë analiza për fillimin dhe implementimin nga MASHT ,në kemi qenë në fazën e testimet në shkollat si dhe mundësi të fillojmë implementimin e tyre , Gjate kësaj periudhë në sektorin e IT janë bërë 42 formatizime dhe janë bërë intervenime tek institucionet komunale shëndetësi arsim si dhe shkollat e komunës si dhe janë bërë shumë punë tjera duke përfshirë krijimin në SIMBNJ 120 kyçje në sitëm dhe 240 qasje në HRM SYSTEM . Nga lëmi e servisimit të pajisjeve të IT janë servisuar shumë pajisje duke pasur problem me rrym dhe kanë shkaktuar dëme në pajisje të IT-së janë djegur 16 Poëer suplai (pajisje të furnizimit me rrym) dhe janë përforcuar 15 pc me ram memorie pasi që na është dashur të kalojmë nga sistemet e vjetruara në të avancuara. Janë bërë incizimet e mbledhjeve të kuvendit si dhe transmetimi drejt përderej me tele-prezencë në MAPL dhe kam bërë edhe kyçjani në CMS ,

Njësia për të Drejtat e Njeriut

Zyrtaret e kësaj njësie gjate gjashtëmuajorit të parë të vitit 2021, kanë marrë rregullisht pjesë në mbledhjet e K. Komunitete, KPF, KK dhe KKSBB si dhe pjesëmarrja në komisione të ndryshme.

Si dhe ka qenë pjesëmarrëse në takimet Online me temat, si vijon:

- Drejtat e Njeriut dhe diskriminimi në Shoqërinë tone organizuar MAPL
- për personat e pagjetur
- fuqizimi ekonomik i gruas,organizuar nga rrjeti i grupit të grave
- dhuna në familje në kohe pandemike“organizuar nga ministria e drejtësisë
- raportim në Agjensionin për Barazi Gjinore
- takimin e ABGj në platformën online
- trajtimi i një rasti nga minoriteti rom (ankesë për mos respektimin e të drejtës nga skema sociale lirim pagesës për rrymën elektrike)
- Vizitë në Plemetin për regjistrimin e fëmijëve në ciklin parashkollor (tek komuniteti Rom Ashkali)kjo visit vazhdon edhe në ditët në vijim.
- pjesëmarrja në punëtorin me temën” Mekanizmat Mbrojtës të Komunitetit për të adresuar shqetësimet e grave dhe vajzave ndaj dhunës në familje dhe shoqëri”organizuar nga Qendra Rinore me mbështetje të OSCE.
- Pjesëmarrja në punëtorin për Performance Komunale ,organizuar nga DEMOS
- Pjesëmarrja në punëtorin me disa nga anëtarët e Mekanizmave Komunal Kundër dhunës në Familje,organizuar nga OSCE.

Nga DAP-ja, Gjate kësaj periudhe janë realizuar këto projekte përmes prokurimit:

- “Projekti i Lanit dhe Live stream për objektin e Komunës (Jemi në pjesën finale të rregullimit, organizimit të kabllove të llanit, dhe transmetimi drejtpërdrejt të mbledhjeve të asamblesë komunale) ,
- Fillimi i punimeve për menaxhimin e radhës -“Pajisje kompjuterike”.
- “ Mirëmbajtja higjienike dhe pastrimi i objekteve të komunës dhe QPS “
- “Veshja me llamarinë e raftëve të arkivës

Drejtoria e Arsimit: Raporti i Punës 01.01.2021 – 30.06.2021

Drejtoria e Arsimit dinamiken e aktiviteteve dhe angazhimeve e ka planifikuar duke e bazuar në planin vjetor të punës për vitin 2021, përkatësisht prioritet në DA është *ngritja e cilësisë në mësimdhënie dhe të të nxënësve* si *synimin* parësor, duke mos lënë anash edhe përmirësimin e kushteve tjera e posaçërisht të infrastrukturës shkollore, ku do të vije në shprehje mësimdhënia dhe mësimnxënia sipas kriterëve avancues të shkollave moderne.

Plani i punës i DA-së është specifik sa i takon aspektit kohor, viti shkollor përkatësisht ai mësimor nuk përputhen me vitin kalendarik, përkatësisht viti shkollor fillon në shtator të vitit paraprak, në këtë rast raporti i gjashtëmujorit të parë (janar- qershor 2021), në arsim përfshinë raportin e gjysmë vjetorit të dytë të vitit shkollor 2020-2021 .

Viti shkollor ka filluar me 14.09.2020 dhe ka përfunduar sipas kalendarit të vitit shkollor 2020-2021 i përshtatur nga MASHTI, duke pasur parasysh që ishte një vit i përcjellur me Pandemi Covid-19, pothuajse në tërë viti shkollor mësimi u zhvillua me skenarin A, me prezencën fizike të nxënësve në shkollë, falë përgaditjes së objekteve shkollore sipas masave mbrojtëse anti Covid -19 nga DA-ja dhe perkujdesjes-angazhimit maksimale të stafit arsimor, QKMF-së, prindërve të nxënësve dhe shumë faktorë tjerë.

Sipas kalendarit të përshtatur për përfundimin e vitit shkollor 2020/21 në rrethanat e Pandemisë Covid-19, testi i arritshmërisë është mbajtur më 28.05.2021, ndërsa testi i maturës është mbajtur me 26.06.2021.

Regjistrimi i nxënësve në klasën e parë dhe parafillor, është bërë duke zbatuar kalendarin e përshtatur për përfundimin e vitit shkollor 2020/21 në rrethanat e Pandemisë Covid-19, është organizuar dhe realizuar regjistrimi i nxënësve në klasën e parë në të gjitha shkollat fillore.

Janë realizuar 4 konkurse për drejtorë dhe zëvendës drejtorë në institucione shkollore si në vijim:

Drejtor në SHFMU "Pandeli Sotiri" Obiliq

Drejtor në SHFMU "Hasan Prishtina" Milloshevi

Zëvendës drejtor në SHFMU "Hasan Prishtina" Milloshevi

Zëvendës drejtor në SHFMU "Dr. Ibrahim Rugova" Obiliq

Janë në proces edhe 4 konkurse për drejtorë në këto IA:

Drejtor në SHFMU "Migjeni" Siboc

Drejtor në SHFMU "Fazli Graiçevci" Hade

Drejtor në SHFMU "Abdurrahmon Gërguri" Dardhishtë

Drejtor në Insitucioni Parashkollor "Rrita Jonë" Obiliq

Regjistrimi i nxënësve në klasën e dhjetë, në afatin e parë është realizuar me datat 28.06.2021-30.05.2021.

Projektet Kapitalë filluara dhe në proces të tenderimit janë:

1. Ndërtimi i kopshtit të fëmijëve në fshatin Mazgit të Poshtëm, donacion nga Bashkimi Evropian.
2. Blerje paisjeve për shkollë, vegla pune, projekti është në proces
3. Paisja e shkollave me kabine të shkencave (Kimi, Fizikë dhe Biologji) janë në proces
4. Blerja e kalldajës për ngrohje në SHFMU "Fazli Graiçevci" PNF Palaj
5. Renovimi i Objektivit shkollor në SHMLP "Ismail Dumoshi" Obiliq dhe Gjimnazin "17 Shkurti" Obiliq, janë në proces

6. Funkcionalizimi i kamerave dhe alarmeve në SHFMU”Hasan Prishtina “ Milloshevë , SHMLP “Ismail Dumoshi” Obiliq dhe Gjinnazin “17 Shkurti” Obiliq janë në proces
7. Renovimi i Objekteve shkollore – në realizim

Trajnimet e mësimdhënësve

Edhe pse ishte pandemi nga COVID -19 në këtë gjashtë mujor kanë vazhduar disa trajnime,ku 15 edukatorë e edukatore dhe 84 mësimdhënës kanë përfunduar këto trajnime: Përgatitja e edukatoreve parafillor për përkrahjen dhe zhvillimin e potencialit të fëmijëve përmes lojës dhe kreativitetit ;Plani Individual i arsimit (PIA);Prodhim material didaktik;menaxhimi istresit tek nxënësit pas pandemisë COVID-19;mësimdhënia në distancë;metodologjia me nxënësin në qendër ;PIA dhe mënyra e zbatimit të tij me nxënësit me nevoja të veçanta .

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
Suksesi nënxënësorë në fund të gjyrmësve të vitit 2020-21
Arsimifillor (1-5)
 Komunat e Obiliqit

Klasa	Nr. paraleleve	Nr. nxënësve	Suksesipozitiv												Numri i mungesave				
			Shkëlqyeshëm		Sh. mirë		Mirë		Mjaftueshëm		Gjithsej me nota pozitive		Gjithsej me nota negative		Të pa notuar		Të arsyeshme	Të paarsyeshme	Gjithsej
			Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%			
1	19	305	221	72.5	47	15.4	27	8.85	10	3.28	305	100	0	0	0	0	1267	937	2204
2	19	324	208	64.2	66	20.4	41	12.7	9	2.78	324	100	0	0	0	0	1896	851	2747
3	19	360	214	59.4	72	20	59	16.4	12	3.33	357	99.2	3	0.83	0	0	1984	1774	3758
4	19	321	184	57.3	75	23.4	44	13.7	15	4.67	318	99.1	3	0.93	0	0	1248	1339	2587
5	18	333	177	53.2	69	20.7	53	15.9	32	9.61	331	99.4	1	0.3	1	0.3	1487	1294	2781
GJ	94	1643	1004	61.1	329	20	224	13.6	78	4.75	1635	99.5	7	0.43	1	0.06	7882	6195	14077

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
 Suksesi i nxënësve në fund të gjysmëvjetorit të dytë 2020
 Arsimi i mesëm i ulët (6-9)
 Komuna _ Obiliq

Klasa	Nr. paraleleve	Nr. nxënësve	Suksesi pozitiv												Suksesi i pamjaftueshëm			Numri i mungesave									
			Shkëlqyeshëm			Sh. mirë			Mirë			Mjaftueshëm			Gjithsej me nota pozitive	Me 1 notë të pamjaftueshme	Me 2 nota të pamjaftueshme	Me 3 nota të pamjaftueshme	Përcillen në riprovim	Përsërisin klasën	Të pa notuar	Të arsyeshme	Të pa arsyeshme	Gjithsej			
			Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%											Nr	%	Nr
6	19	353	116	32.9	69	19.5	98	27.8	38	10.8	321	90.9	14	4	4	1.1	14	3.97	0	0	0	0	0	0	1074	1122	2196
7	19	309	82	26.5	81	26.2	82	26.5	36	11.7	281	90.9	23	7.4	3	1	2	0.65	0	0	0	0	0	0	3733	1091	4824
8	19	353	92	26.1	72	20.4	84	23.8	69	19.5	317	89.8	20	5.7	14	4	2	0.57	0	0	0	0	0	0	2551	2312	4863
9	18	304	78	25.7	53	17.4	95	31.3	65	21.4	291	95.7	11	3.6	2	0.7	0	0	0	0	0	0	0	0	3490	1605	5095
GJ	75	1319	368	27.9	275	20.8	359	27.2	208	15.8	1210	91.7	68	5.2	23	1.7	18	1.36	0	0	0	0	0	0	10848	6130	16978

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

Suksesi i nxënësve në fund të gjysmëvjetorit të dytë 2020-21

Arsimi i mesëm i lartë (10-12)

Komuna _ OBILIQ

Klasa	Nr. paraleleve	Nr. nxënësve	Suksesi pozitiv												Suksesi i pamjaftueshëm				Numri i mungesav								
			Shkëlqyeshëm			Sh. mirë			Mirë			Mjaftueshëm			Gjithsej me nota pozitive			Përcillen në riprovim		Me 1 notë të pamjaftueshme	Me 2 nota të pamjaftueshme	Përsërisin klasën	Të pa notuar		Të arsyeshme	Të paarsyeshme	Gjithsej
			Nr	%		Nr	%		Nr	%		Nr	%		Nr	%		Nr	%				Nr	%			
10	10	233	32	13.7	60	25.75	70	30	37	15.9	199	85.41	8	3.43	21	9.01	3	1.29	2	0.86	900	747	1647				
11	10	233	31	13.3	33	14.16	65	27.9	63	27	192	82.4	18	7.73	14	6.01	4	1.72	5	2.15	870	931	1801				
12	12	218	36	16.5	31	14.22	55	25.2	64	29.4	186	85.32	21	9.63	5	2.29	2	0.92	4	1.83	903	877	1780				
Gjiths	32	684	99	14.5	124	18.13	190	27.8	164	24	577	84.36	47	6.87	40	5.85	9	1.32	11	1.61	2673	2555	5228				

Drejtoria e Infrastrukturës: Raporti i Punës 01.01.2021 – 30.06.2021

Drejtoria e Infrastrukturës gjatë kësaj periudhe kohore ju kemi përgjigjur kërkesave të qytetarëve në bazë të kërkesave kemi punuar paramasat paralogaritë projektet për përmirësimin e kushteve të jetës se tyre.

Kemi dërguar shkresa për institucione të ndryshme, kemi realizuar projekte në bazë të kërkesave të drejtorive tjera komunale.

Jemi duke menaxhuar kontrata si për DIL ashtu edhe për drejtoritë tjera kërkuese të komunës.

Kemi realizuar projekte për donatorë, marrëveshje me pronarë privat rreth investimeve kapitale dhe përgatitja e dokumentacionit për evidentim në kadastër për evidentimin e parcelave në të cilën planifikohet shkitirja e rrjeteve të kanalizimit ujësjellësit dhe rrugëve

Cdo projekt i cili ka ardhur nga kompani projektuese në të cilën kemi dhe kontratë e kemi kontrolluar para se të shpallet në tender, për arsye të mos kemi probleme gjatë ekzekutimit etj.

PROJEKTET TË CILAT JANË PUNUAR NGA NDREJTORIA E DIL-it për drejtoritë komunale:

Për drejtinë e DIL-it
1. Ndërtimi I Urës Automobilistike në Komune e Obiliqit, Fshati Grabovc, Rruga Bajram Mjeku
2. Ndërtimi I Urës Këmbësorike Metalike ne Grabovc/Rr. Bajram Mjeku
3. Ndërtimi I Brezit të gjelbërt Kosova A (trotuari, shtigjet për biciklista, ndricimi dhe kanalizimi atmosferik)
4. Diskolimi I Gypit të ujitjes së Ibër Lepencit
5. Trotuari dhe Ndricimi Obiliq-Plemetinë
6. Riparimi I rrugës Sabedin Pllana-Lajthishtë
7. Plemetinë Rr. Sokoli seg.1 L=2124m B=4
8. Rrugë që janë duke u punuar në fshatin Grabovc

9.Objekti për pastrimin e Kufomave P+NK	
10.Sistemi I Ujitjes pik pik për brezin e gjelbërt Kosova A	
11.Ndërtimi I shtratit të prrockës në rrugën Mbretëresha Teutë	
12.Ndërtimi I Urës në rrugës Roga Graboc	
13.Ndërtimi I krojeve dhe kanali I ujit për Mullinjët në fsh Graboc	
14.Ndërtimi I objektit për parking Mbitoksor.	
15. Ndricimi Plemetin Obiliq	
16. Ndricimi Publik për teritorin e Obiliqit	
17. Kyqja e Bibliotekës	
18. Paisjet elektrike për shtëpinë e shëndetit	
19.Raportet për Efiqencë	
20. Graboc vazhdimi I Rr. Islam Mjeku L=330m, B=3m	
21. Lajthishtë Rr. Shtabi I UCK-së seg 1 L=120m B=3m	
22. Llazarevë Rr. Viktoria seg 1 L=210m B=3.5m	
23.Llazarevë Rr.Viktoria seg 2 L=140m B=3.5m	
24. Bakshi Rr. Ushtarët e UCK-së seg 1 L=121m B=3.5m	
25. Paramasa dhe parallogaria e fushave sportive ne fsh. Breznice Grabovc, Sibovc, Palaj, Dardhishte dhe Hade e re	
26. Paramasa dhe parallogaria e objektit te Sheshi Deshmoret e Qytetit	
27. Hartimi I proejktit dhe paramasa per konstruksionin metalik per mbulesen e parkingjeve ne QKMF-Obiliq	
28. Asfaltimi I rrugëve rurale ne fshatin Raskove-Millosheve Pjesa e dytë	
29. Punimi I projektit për parkun në Breznicë	
30. Punimi I projektit për Parkun në Graboc	
31. Punimi I projektit për renovimin e Shkollave në Obiliq	
32. Punimi I projektit për ngjyrosjen e Gjinnazit dhe Shkollës Teknike	
33. Punimi I projektit për këndin e lojërave Obiliq	

PROJEKTET TË CILAT JANË PROJEKTUAR TENDERUR DHE JANË DUKE EKZEKUTUAR
Paramasa dhe Paralogaria për rrugët e Milloshevës Llazareve Bakshi dhe Raskovë
1. Ndërtimi I “Sheshit të Qytetit” proejkte është në fazën përmbyllëse
2. Rikonstruimi I banesave sociale-Rikonstruimi I fasadës dhe lokaleve për objektin kolektiv
3. Ndërtimi I sheshit “Adem Preniqi”
4. Ndërtimi I rrugëve në lagjen Hade e Re
5. Asfaltimi I rrugëve në fsh Mazgit&Dardhishtë
6. Asfaltimi I rrugëve në fsh Millosheve faza e parë
7. Asfaltimi dhe kubëzimi I rrugëve në Obiliq
8. Asfaltimi I rrugëve në fsh Milloshevë-Raskovë faza e dytë
9. Ndërtimi I Objekteve të Komunitetit në fsh Breznicë dhe Kozaricë
10. Ndërtimi I trotuarit dhe Ndrimit Plemetinë-Obiliq

Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale: Raporti i Punës 01.01.2021 – 30.06.2021

Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale gjatë muajve janar- qershor 2021 në kuadër të përgjegjësisë së veta ka kryer punë dhe detyra të shumta duke përfshirë edhe menaxhimin me situatatën e krijuar me Pandeminë COVID 19.

- Janë realizu takime të shumta me MSH, IKSH, OBSH, Kolegjiumin e Shëndetësisë. Janë diskutu tema nga më të ndryshmet si: menaxhimi I Pandemisë, fillimi I vaksinimit, sigurimi I testeve antigjene, trajnimi I ekupeve për vaksinimin e qytetarëve me vaksinën kundër virusit COVID 19.

- Kujdesi Shëndetësor i Qasshëm dhe Cilësor projekt i vazhduar i bashkëpunimit ku ne si Komunë jemi në mesin e dymbëdhjetë Komunave të përzgjedhura nga kjo OJQ.Projekti implementohet nga Seiss TPH and Save the Children dhe përfitimet nga ky bashkëpunim janë të shumfishta si: ngritja e kapaciteteve njerëzore në ofrimin e shërbimit cilësor shëndetësorë.

- Janë lidhë marrëveshje bashkëpunimi në mes Kryetarit të Komunës z.Xhafer Gashi dhe Islamic Relief Kosova. Ky bashkëpunim avancon ofrimin e shërbimeve mjekësore për qytetarët tanë përmes angazhimit të 11 profesionistëve shëndetësorë në projektet: “Kujdesi shtëpiak për lehonat, kujdesi për personat e moshës së tretë dhe me aftësi të kufizuar”.
- Takime të rregulta me KFOR-in, në fokus ngritja e cilësisë shëndetësore me prioritet të veçantë në shërbimin e emergjencës si dhe mbështetje në ligjerata dhe trajnime.
- Takime me Fondacionin e Katarit, po ashtu janë mbajtur takime me Fondacionin e Kuvajtit dhe OJQ-në “Qëndresa Kosovare” lidhur me donacionet e mundëshme.
- Gjatë gjithë kohës së Pandemisë COVID 19, me përkushtim I gjithë personeli shëndetësorë si dhe stafi mbështetës kanë kryer detyrat dhe misionin e vet duke ofru ndihmë mjekësore të gjithë pacientëve në kushte ambulatore, teren, në shtëpi dhe në çdo vend tjetër ku është kërkuar, dhe sipas nevojës transportin e pacientëve në klinikat e QKUK-së dhe anasjelltas.
- Gjatë këtijë gjashtëmujori nga personeli shëndetësorë kanë qenë njëmbëdhjet (11) të infektuar me virusin COVID19. Që nga fillimi I Pandemisë e deri më sot janë testu 4444 persona, nga ta:1859- Kanë rezultu pozitiv, 1804- Të shëruar, 4 –aktiv, 51- Të vdekur.
- Të gjitha familjet e vetëizoluara janë kontaktu nga Epidemiologia jonë. Janë rekomandu për masat e vetëizolimit si dhe ju janë përsërit masat mbrojtëse të cilat duhen të ju përmbahen po ashtu të kërkojnë në mënyrë urgjente ndihmë mjekësore nëse kanë ndonjë shqetësim apo përkeqsim të gjendjes shëndetësore. Po ashtu që nga rasti i parë i paraqitur pozitiv me COVID 19 është ofru mbështetje logjistike për të gjitha familjet e vetizoluara nga Kryetari i Komunës së Obiliqit.
- Me arritjen e vaksinave kundër infeksionit me virusin COVID 19, më dt.29.03.2021 ekipi mjekësor i përbërë nga një mjek dhe dy teknik qysh në orët e mëngjesit u pozicionu në sallën “1 Tetori” Prishtinë, ku pritej të fillonte procesi i vaksinimit.Ekipi i QKMF-së Obiliq, nga komuniteti i vaksinimit u caktu si ekip mobil i cili vaksinoi personelin shëndetësorë në klinika. Vaksinimi u realizu sipas planit të vaksinimit të komunitetit për vaksinim. Vaksinimi në komunën e Obiliqit filloi më dt. 07.04.2021, fillimisht me vaksinën AstraZeneca e më vonë edhe me Pfaizer.Kategoritë e lejuara nga komiteti i vaksinimit për teritorin e Kosovës filloi me personelin shëndetësorë duke vazhdu me kategoritë prioritare të caktuara nga komiteti për imunizim.
- Me kërkesë të MSH dhe IKSHPK-së, u përpilua lista me të dhënat e personelit shëndetësorë për vaksinim kundër COVID-19, me të sëmuret kronik dhe individët mbi moshën 80 vjeçare.

Sasia e vaksinave të dhëna nga 07.04.2021 deri më 30.06.2021 në QKMF-Obiliq

- AstraZeneca: doza e parë =622
- Astra Zeneca: doza e dytë =254
- Pfaizer: doza e parë =917
- Pfaizer: doza e dytë =237

Me vaksinim do vazhdohet edhe në muajt e ardhshëm, deri në përmbushjen e objektivave të përcaktuara për imunizim të populates në masë, sipas rekomandimeve nga Komiteti për imunizim.

AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA

Ka vazhduar organizimi I punës pa ndërprerje në ambulancën COVID 19 për ofrimin e shërbimeve shëndetësore të pacientëve të rezultuar pozitiv me virusin Corona ku është zbatu orari I plotë. Përkundër mungesës së numrit të mjaftueshëm të personelit shëndetësorë, organizimi I till përballoi nevojat dhe kërkesat për zbatimin e rekomandimeve në parandalimin dhe frenimin e përhapjes së virusit COVID-19.

- Njoftim i vazhdueshëm rreth riorganizimit dhe rrezikshmërisë së përhapjes së virusit COVID19.
- Shërbime shëndetësore, cilësore 24/7.
- Gadishmëri e organizuar në ekipe mjekësore për transportimin e pacientëve të dyshuar dhe pozitiv me COVID 19.
- Sigurimi i autoambulancës vetëm për rastet e infektuara me virus.
- Mbështetje dhe asistencë me ekipe mjekësore në Aeroportin e Prishtinës.
- Vizita të vazhdueshme monitoruese të gjitha njësive të QKMF-së.
- Furnizim me material shpenzues mjekësor.
- Furnizim me material për shërbime laboratorike.
- Furnizim me material administrativ shëndetësorë.
- Furnizimi me pako ushqimore dhe higjienike për familjet e izoluara si dhe familjet në nevojë.
- Pranimi i testeve antigjene në QKMF.
- Kordinimi i aktiviteteve në mes qendrës së vaksinimit dhe IKSHPK-së për fillimin e procesit të vaksinimit.
- Takime të vazhdueshme me menaxhmentin e QKMF-së.
- Përgaditja e Qendrës së Vaksinimit në shtëpinë e kulturës “Xhavit Haziri” për fillimin e vaksinimit kundër virusit COVID 19.
- Vaksinimi i rregullt për fëmijët e grup moshave të caktuara sipas kalendarit të vaksinimit si dhe vaksinimi i nxënësve.
- Identifikimi i nevojave për përmirsimin e shërbimeve shëndetësore në kuadër të KPSH-së.
- Identifikimi i nevojave për lehtësimin e punës së përditshme të personelit.

- Dezinfektimi i QKMF-së, QMF, AMF dhe autoambulancave në baza ditore (deri tri herë në ditë).
- Ndërprerja e pushimeve vjetore si dhe rritja e kritereve për pushime mjekësore.
- Përgaditje teknike dhe administrative për hapjen e konkurseve.
- Përgaditje e specifikave për procedur prokurimi.
- Përmirsimi i infrastrukturës së institucioneve të KPSH.

Inventarizimi.

- Ekipet mjekësore të QKMF-së kanë asistuar dhe mbështetur aktivitetet kulturo-sportive.
- Takime të përditshme me qytetarë.
- Janë kryer punët e përditëshme tekniko- administrative (fatura, kërkesa).

Komuna Obiliq në bashkëpunim me Qendrën për Punë Sociale ndihmon me pako ushqimore dhe higjenike 300 familje në nevojë.

UNICEF përmes Ballkan Sunflooërs bashkëpunim me QKMF-në, bën shpërndarjen e 242 pakove për fëmijë me kushte të rënda ekonomike.

Më 100 pako ushqimore dhe higjenike u mbështeten familjet në nevojë nga Poligoni i Shenjëtarisë “Katana”, Obiliq.

Fondacioni “Freskia” ndihmon familjet në nevojë me 100 pako ushqimore dhe higjenike. Bashkëatdhetari z.Ujup Preniqi, ndihmon me 40 pako ushqimore dhe higjenike familjet në nevojë.

Ambasada e Emirateve të Bashkuara Arabe, ndihmon 85 familje me pako ushqimore dhe higjenike.

UN ndihmon me 80 pako ushqimore dhe 80 higjenike familjet në nevojë.

Në bazë të kompetencave që i dalin nga ligji nr.03/048, ligjit për shërbime sociale dhe familjare nr.02/L-17, Statutit të Komunës nr.01/34, konformë rregullorës nr.108, DSHMS shpallë Thirrje Publike për blerjen e këtyre shërbimeve të veqanta:

- I. Shërbime sociale dhe familjare për fëmijët pa përkujdesje prindërore
- II. Shërbime për personat me aftësi të kufizuara
- III. Shërbime për pensionist

Vlera e planifikuar për blerjen e të gjitha këtyre shërbimeve në total është 9,500.00€.

Pranimi i kërkesave për nevoja sociale dhe shëndetësore:

Janë pranuar 183 kërkesa nga palët nevojtare.
130 prej tyre janë të realizuara,
57 të refuzuara.

Gjatë këtij gjashtëmujori janë realizu 132 kërkesa të Lehonave.

-Gjatë këtijë gjashtë mujori të vitit 2021 nga DSHMS janë inicua procedurat e prokurimit për projekte dhe shërbime tjera për nevojat e QKMF-së dhe QPS:

1- Renovimi i Objekteve të QKMF, QMF, AMF, QPS, Shtëpia e Pleqëve: 20,000.00€

2- Paisje mjekësore për QKMF-në: 30,000.00€

3- Inventar për QKMF dhe njësitë: 10,000.00€.

4- Blerja e autoambulancave/ veturave: 19,175.00€.

5- Paisje elektrike QKMF, QMF dhe AMF: 10,000.00€

Raporti i shpenzimeve

MALLRA DHE SHERBIME	Zotimi
Material gjinekologjik-radilogjik	4,400.00
Material ampullar	8,844.68
Material laboratorik	14,029.00
Material administrativ	1,000.00
Furnizim me material stomatologjik	810.00
Karburante për vetura	2,021.44
Regjistrimi I automjetit	105.00
Interneti	88.47
Sherbime me aparat fotokopjues	74.01
Furnizim me pako ushqimore	14,994.00
Mirëmbajtja e objekteve	4,580.00
Vendime gjyqësore- paga jubilarë	26,927.07
Furnizime mjekësore	157.74
Avans për para të imta	1,000.00
Paisje elektrike QKMF,AMF dhe QMF	10,000.00
Blerja e autoambulancave	19,175.00
Inventar për QKMF	10,000.00
Paisje mjekësore për QKMF	30,000.00
Renovimi I objekteve në QKMF,AMF dhe QMF	20,000.00

KOMUNALI		
	Rrymë elektrike	13,511.97
	Uji	604.31
	Telefon	576.63

NUMRI I PACIENTËVE DHE NUMRI I SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE

Nr	QENDRA KRYESORE E MJEKËSIS FAMILJARE	Numri i pacientëve	Numri i shërbimeve mjekësore
1.	QKMF OBILIQ	47428	106505
2.	QMF MILLOSHEVË	2513	5912
3.	QMF PLEMETIN	92	1815
4.	AMF SIBOC	1295	4005
5.	AMF BREZNICË	949	2015
6.	AMF B.MOFC	1259	4883
	TOTALI:	53536	125135

REFERIMET

JANAR-QERSHOR 2021

QKMF -Obiliq		Nr. i referimeve PËR KONSULTIME në kujdesin tretësor	Nr. i referimeve në DIAGNOSTIKËN e kujdesit tretësor	Nr i referimeve në QENDRËN EMERGJENTE	Gjithsej Udhëzime për Kujdesin tretësor	Numri i përgjithshëm i vizitave mjekësore	Përqindja (%) e të referuarve në kujdesin tretësor
Njësia	Departamenti						

1	QKMF Obiliq	Mjekësi Familjare	2107	296	40	2443	18517	13.1%
2	QKMF Obiliq	Emergjenc ca	115	24	491	630	5930	10.6%
3	QKMF Obiliq	Pediatria	745	92	0	837	4304	19.4%
4	QKMF Obiliq	Gjinekologjia	117	9	0	126	674	18.6%
5	QKMF Obiliq	Shëndeti oral	67	188	0	255	1879	13.5%
5	QMF Milloshevë	Mjekësi Familjare	248	35	178	461	2271	20.2%
7	QMF Milloshevë	Shëndeti Oral	3	28	0	31	244	12.7%
	QMF Plemetin	Mjekësi familjare	0	0	0	0	92	0%
	AMF Breznicë	Mjekësi Familjare	116	68	16	200	949	21%
0	AMF Siboc	Mjekësi Familjare	121	32	4	157	1295	12.1%
1	AMF.Ba Moc	Mjekësi familjare	272	137	0	409	1259	32.4%
			3911	909	729	5549	37414	14.8%

Ne tabelën e mëposhtme janë të dhënat për Sëmundjet masive jo infektive për muajin JANAR-QERSHOR 2021

Të sëmundjeve masive jo infektive,

F00,F04,F05 ,F09,F20,F30,F31,F32.3,F33,F22,F29,F84,G71(shëndetit mental)

2.E10-E14,(sëmundjes së sheqerit)

3.I00-.I02,I20,I21,I24,I25(sëmundjeve kardiovaskulare)

4.N05(nefropatit)N03,N04,N05,N10,N18

5. J42,J45,J47,(sistemit respirator)

6.D65-D69,C-(sëmundje malinje),